

KA.nr.43/2013

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	DPK/DMP
Nr. l faq. Broj stranica Nr. pages	02
Nr Prot. Br Prot. Prot No	03-2697/13
Data Datum Date	06.09.2013
PRISTINE	

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët : Mejreme Zekaj kryetare, Biljana Rexhiq dhe Ramiz Kuqi anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores, Sabahate Hoti, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë, kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Ferizaj, Nr.regj.11528/2012 të dt. 29.11.2012, në bazë të nenit 31 al. 3, 39 dhe 221 të Ligjit mbi kundërvajtjet, më 28.01.2013 merr këtë:

AKTVENDIM

Ankesa e paraqitur është e bazuar.

NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Ferizaj, Nr.regj.11528/2012 të dt. 29.11.2012, ashtu që të pandehurës Zymrije Haxhimusa, nga fshati Doganaj, për kundërvajtjen nga neni 17 par.1 pika 3. të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtar, i shqiptohet dënimi me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) Euro, të cilën gjobë ka për ta paguar në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, në të kundërtën gjoba e shqiptuar do t,i zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 30-ditësh.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve në procedurë.

Arsyetim

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Ferizaj, sipas aktvendimit Nr.regj.11528/2012 të dt. 29.11.2012, e ka PEZULLUAR procedurën kundërvajtëse ndaj të pandehurës Zymrije Haxhimusa, për kundërvajtjen nga neni 17 al.1. pika 3. të Ligjit nr.04/L-040, konform të nenit 198 al. 1. pika 8. të Ligjit për Kundërvajtjet, në mungesë të provave.

Kundër këtij aktvendimi Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë, ka paraqitur ankesë për shkak të vendimit mbi dënimin, me arsyetim se: gjykata e shkallës së parë e kaz pezulluar procedurën sipas nenit 198. al.1 pika 8 të LK-së, për shkak e pandehura nuk e ka pranuar personalisht formularin për deklarin e pasurisë , por, konstatojmë se janë plotësuar kushtet sipas nenit 4 të këtij Ligji, pasi që ajo është njoftuar për obligimin e saj drejtpërdrejtë nga zyrtari kontaktues. Andaj, të gjitha faktet dhe rrethanat tregojnë se e pandehura e ka kryer kundërvajtje për të cilën ngarkohet. Propozon që aktvendimi i shkallës së parë të priset dhe lënda të kthehet në rigjykim, ose ndaj të pandehurës të shqiptohet dënimi merituar sipas ligjit.

Kolegji i kësaj gjykate duke i vlerësuar thëniet në ankesë, aktvendimin e goditur dhe shkresat tjera të lëndës konstatoi se ankesa e paraqitur është e bazuar.

Kolegji vlerësoj thëniet në ankesën e parashtruar aktvendimin e goditur, deklarin e të pandehurës Zymrije Haxhimusa, në seancën e shqyrtimit kryesor në procesverbal të dt.27.09.2012, e cila në mbrojtjen e vet e mohon të ke qenë e njoftuar në mënyrë të rregullt për obligimin për deklarimin e pasurisë; dëshmisë së dëshmitarit Afrim Matoshi, zyrtari-i Kuvendit, të dhënë në procesverbal të dt.03.10.2012 i cili dëshmon se formularët për deklarimin e pasurisë i ka shpërndarë personalisht në të gjitha ulëset e Kuvendit Komunal në Ferizaj në mbledhjen e Kuvendit të dt.09.03.2012; dëshmisë së dëshmitarit Naser Musa-zyrtar kontaktues i Komunës, të dt.03.10.2012 i cili gjithashtu dëshmon se: duke marr parasysh se të gjithë delegatet nuk posedojnë email , unë jam marr vesh me kryesuesin e Kuvendit Agim Aliu që materialin për deklarimin e pasurisë ta shpërndajmë për të gjithë delegatet për mbledhjen e Kuvendit e dt.09.03.2012, kur dhe e kam shpërndarë materialin nëpër tavolina ku kryesuesi i Kuvendit Agim Aliu, në fillim të mbledhjes i ka njoftuar delegatët se në tavolina e kanë materialin dhe se duhet të deklarojnë pasurinë, e si dëshmi për këtë në shkresat e lëndës e ka deponuar si provë regjistrin e delegatëve pjesëmarrës në mbledhjen e Kuvendit Komunal të dt.09.03.2012; dëshmisë së dëshmitarit Agron Behrami-zyrtar i AKK-së, në procesverbal të dt..2.11.2012, i cili dëshmon se pika kontaktuese për zyrtarët e Kuvendit të Komunës të Ferizajit, Naser Musa, ka qenë i njoftuar me kohë me dokumentacionin për informim të delegatëve për deklarimin e pasurisë, si dhe në bazë të provave tjera konstatoj se:

Gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar drejtë provat e nxjerra dhe të deponuara në gjykatë, e si pasoj e ka pezulluar procedurën kundërvajtëse ndaj të pandehurës Nexhmije Haxhimusa edhe pse siç u cekë më lartë është konstatuar se e pandehura ka qenë e njoftuar për obligimin për deklarimin e pasurisë , por një gjë të tillë nuk e ka bërë me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 17 par.1 pika 3 të Ligjit për deklarimin Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat zyrtar, për çka kolegji ndryshoj aktvendimin e goditur ashtu që të paditurës Nexhmije Haxhimusa për veprën e kryer për kundërvajtëse si më lartë ia shqiptoj dënimin me gjobë në shumë prej 500 €, duke pasur për bazë të gjitha faktet dhe rrethanat e kryerjes së veprës së kundërvajtëse. Duke marr për bazë faktin se e pandehura për herë të parë ka ra ndesh me ligjin se është hera e parë që është e obliguar që ta deklaroj pasurinë, se ndërkohë gjegjësisht me dt.11.09.2012 e ka bërë deklarimin e pasurisë, kolegji vendosi që ndaj të pandehurës ta bëjë zbutjen e dënimit nën minimumin ligjor për këto lloj kundërvajtje si më lartë , konform neni 3 dhe 9 të LK-së, duke pasur për bazë edhe dispozitat e neni 7 të LK-së dhe duke llogaritur se edhe me këtë gjobë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit, ashtu që e pandehura në të ardhmen të mos kryej vepra kundërvajtëse të njëjta, apo të ngjashme.



Konform të neni 221 të LK u vendës si në diapozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS.

KA. nr. 43/2013 të dt.28.01.2013

Procesmbajtësja,
Sabahate Hoti



KRYETARI I KOLEGJIT,
Mejreme Zekaj

